

NEWSLETTER

Tetor

Albsig, pjesë e
Panairit
“Agrotech Expo
2023”



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

Shorteu me i ri i
Albsig “Kontrollo,
Parandalo, Siguro”

një nismë e re në
ndihmë të çdo gruaje,
vajze në kuadër të
ndërgjegjësimit
kundër kancerit të
gjirit.

Apeli i Albsig: Jo vetëm
në “Tetorin Rozë”,
muaji i ndërgjegjësimit
ndaj kancerit të gjirit

Rritje me 20% e
rasteve me kancer gjiri,
mjekja: Grupmosha
50-70 vjeç, më e
prekura

Shërbime spitalore falas
për gratë dhe vajzat e
stafit të Albsig.

Pensionet Private, Fondi “Albsig Invest” sh.s.,
Alternativa e Duhur për Shqiptarët

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo – Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.





BREAST CANCER

OCTOBER

AWARENESS
MONTH



Albsig, pjesë e Panairit “Agrotech Expo 2023”

Albsig merr pjesë në edicionin e 4-të të Panairit Ndërkombëtar “AGROTECH Expo 2023”, organizuar nga Expocity Albania për promovimin e sektorit Agro me kategori bujqësi, blegtori, kopshtari dhe ndikimin që kanë sigurimet në këtë sektor kaq të rëndësishëm. Në fokus të panairit janë sfidat e bashkëpunimit rajonal si dhe nxitja e eksporteve në tregjet ndërkombëtare. Në ceremoninë hapëse të panairit të bujqësisë “AGROTECH Expo 2023”, i cili u zhvillua gjatë datave 18 deri më 20 Tetor, me një larmishmëri produktesh bujqësore, nga ushqimi organik dhe agroturizmi deri te ambalazhimi dhe inovacioni në makineritë bujqësore.

Ky panair bëri bashkë aktorët më të rëndësishëm të sektorëve kombëtar dhe ato ndërkombëtar. Qëllimi kryesor i këtij eventi ishte krijimi i mundësive për bashkëpunime biznesi për çdo fermer dhe të interesuarit e këtij sektori. Në AGROTECH Expo 2023 morën pjesë kompani nga vende të ndryshme si Kosova, Maqedonia e Veriut, Greqia, Italia Serbia si dhe nga Gjermania. Përgjatë datave 18-20 Tetor 2023 vizituan panairin, një numër i konsideruar konsumatorësh ku u ndalën dhe në stendën e Albsig-ut.

“Së bashku sot për një të Nesërme të SIGURTE!”, ishte dhe slogani i Albsig pjesëmarrës në eventin e organizuar. Ky panair i ofrohet sektorëve dhe tregut si platforma më e rëndësishme e bashkëpunimeve të biznesit si dhe e promovimit dhe prezantimit tek të gjitha hallkat, duke nisur nga konsumatori final, fermeri e deri tek furnitori e më pas prodhuesi.

Kjo duke sjellë sëbashku aktorët më të rëndësishëm kombëtarë, rajonalë e ndërkombëtarë, në sektorët e makinerive bujqësore, kimikateve, plehrave kimike, agropërpunimit, konservimit, magazinimit, ambalazhimit, paketimit të produkteve bujqësore dhe transportit, ushqimit organik dhe agroturizmit. Në sajë të vëmendjes ndërkombëtare, AGROTECH Expo 2023, përmes eventeve të targetuara, forumeve dhe Ërkshopeve informues e edukativ, do t’u ofrojë sipërmarrësve lokalë dhe rajonalë, dije dhe ekspertizë mbi depërtimin dhe rritjen në tregje të reja, shkëmbim njohurish specifi-ke mbi sektorin, rrjetëzimin, si dhe informim mbi mundësitë e rritjes së biznesit.

Në Edicionin e 3-të, AGROTECH Expo ka shënuar një rritje prej 60% të numrit total të ekspozuesve, me pjesëmarrje të bizneseve nga Shqipëria, Kosova, Serbia, Greqia, Italia, Turqia, Gjermania e më tej. Që prej shtatorit 2019, AGROTECH Expo është tashmë event anëtar i EURASCO-s (Federatës Europiane të Panairove Bujqësore dhe Organizuesve të Eventeve) ëëë.eurasco.org.

Institucionet shtetërore kryesore, projektet në bujqësi dhe kompanitë lider të sektorit, do të shërbejnë si histori suksesi për potencialin e Shqipërisë në sektorin bujqësor. Gjatë Edicionit të II-të të AGROTECH Expo, ne mirëpritëm në Shqipëri konferencën ndërkombëtare “Global G.A.P Stop Tour”, e cila pati një ndikim shumë të rëndësishëm në sektorin bujqësor, përsa i përket informimit për certi-kimet Global G.A.P., ndërsa në AGROTECH EXPO 2022, patëm një rikthim të tyre nëpërmjet një konference ndërkombëtare të organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Grupi Teknik Kombëtar, duke e kthyer pjesëmarrjen e përvitshme në AGROTECH EXPO në një traditë.



Shorteu me i ri i Albsig “Kontrollo, Parandalo, Siguro” një nismë e re në ndihmë të çdo gruaje, vajze në kuadër të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit.

“Kontrollo, Parandalo, Siguro”; është titulluar shorteu më ri i realizuar nga Albsig për gratë dhe vajzat në muajin tetor. Shorteu është bërë enkas për ti ardhur në ndihmë çdo vajze gruaje në kuadër të sensibilizimit të “Tetorit Rozë”, muaj ky i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit. Përmes rrjeteve sociale Shoqëria e Sigurimeve Albsig ka njoftuar klientët e saj dhe jo vetëm që do të zhvillohej një shorte për konsumatorët e momentit.

Në shorte morën pjesë të gjithë kalimtarët e rastit dhe u udhëzuan për këtë të fundit. “Shorteu” ishte menduar në mënyrë të tillë që një numër i konsiderueshëm konsumatorësh gra dhe vajza të mund të fitojnë shërbime spitalore falas në rrjetet spitalore private me të njohurat në vend. Shorteu zgjati më shumë se dy orë. Procesi u zhvillua para zyrave të Drejtorisë Qendrore të Albsig dhe në të morën pjesë edhe burra ku i bënë dhuratë grave të tyre një vizitë kontrolli falas në spitalet më të mira. Një grup ekspertësh të marketingut udhëzuan kalimtarët e rastit të cilët kalonin para zyrave të Albsig ku dhe po zhvillohej shorteu se si të bëheshin pjesë e lojës.

Shorteu u bë për të lehtësuar procesin e përzgjedhjes së konsumatorëve fitues dhe për ti dhënë mundësi çdo gruaje, vajze që të mund të fitoj shërbime spitalore falas sic ishin Eko apo Mamografi, nismë kjo në kuadër të ndërgjegjësimit të muajit tetor muaj ky i luftës kundër kancerit të gjirit. Për çdo vit Albsig.sh.a pjesë e Kastrati grup ndërmerr nisma të rëndësishme në ndihmë të grave dhe vajzave për të luftuar e sensibilizuar kontrollin kundër kancerit të gjirit.

Është viti i dytë që Albsig bën të mundur kontrollin shëndetësorë falas të të gjitha grave dhe vajzave të stafit. Jo vetëm kaq por dhe rastet që kanë rezultuar me probleme janë suportuar nga kompania deri në zgjidhjen e problematikave shëndetësore. Për Albsig shëndeti vjen i pari. Dhe me këtë shprehje urojmë dhe shpresojmë që çdo nënë, grua vajzë të ketë mundësi të marrë shërbimet e duhura.



Apeli i Albsig: Jo vetëm në “Tetorin Rozë”, muaji i ndërgjegjësimit ndaj kancerit të gjirit




“Mos harro! Mamografia shpëton jetë...”

Në Albsig ne shikojmë me përgjegjësi shumë të madhe çështje sociale, dhe ndiejmë se është detyrë për gjithësecilin prej nesh si një nga kompanitë më të mëdha në vend që jo vetëm t'i sjellim në vëmendje ato por edhe të ofrojmë ndihmën dhe mbështetjen tonë.

Muaji Tetor është muaji i ndërgjegjësimit ndaj kancerit të gjirit dhe ne kuadër të këtij muaji të rëndësishëm për shëndetin e grave, në Albsig kemi vendosur që të ndihmojmë çdo grua që blen çdo produkt në Albsig përfiton eko ose mamografi të gjirit falas. Dhe jo vetëm kaq por menaxhimi i Albsig ka menduar dhe me shumë. Muaji tetor ka qenë i mbushur plot me aktivitetet.

Përveç fushatave sensibilizuese që janë bërë në të gjitha pikat e Albsig edhe në rrethe ajo që vlen të cilësohet është shorteu i zhvilluar para zyrave të Drejtorisë Qëndrore në Tiranë. Në shorte morën pjesë një numër i konsiderueshëm konsumatorësh dhe fituan kontrollet shëndetësore falas. Dhe jo vetëm kaq, por me shumë thirrjeve dhe mënyrave atraktive, në këtë muaj me ngjyrë rozë, duam t'i shtojmë edhe ne zërin tonë, thirrjes ndaj të gjitha grave për të marrë pak kohë për të bërë kontrollin e gjirit.

Diagnostikimi i hershëm i kancerit të gjirit ka dëshmuar se është mënyra më e mirë për të fituar betejën me këtë sëmundje.



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP



 **ALBSIG** *Jetë*

Shërbime spitalore falas për gratë dhe vajzat e stafit të Albsig

Si cdo vit edhe këtë tetor, Shoqëria e Sigurimeve "Albsig Jetë", iu bashkua fushatës për të kontribuar në "Ndërgjegjësimin e Zbulimit të Hershëm të Kancerit të Gjirit". Për Albsig Jetë, mirëqenia e stafit është kryesorja. Në të gjithë rrjetin e shitjeve "Albsig Jetë sh.a." u bëri të mundur bashkëpunëtorëve të saj materiale promocionale shpjeguese dhe mundësi kontrolli shëndetësor falas për siguri dhe transparencë maksimale.

Stafi i femrave të Albsig vendosi një fjongo rozë (simbol i fushatës) tek veshjet e përditshme që do të mbahet përgjatë gjithë muajit. Fushata nisi më 8 Tetor dhe përfundoi në fund të muajit. Konkretisht përmes kësaj fushate u bë e mundur një kontroll falas për të gjitha gratë dhe vajzat e rrjetit bashkëpunëtorë që shoqëria disponon. Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit është një fushatë vjetore ndërkombëtare që synon të shpërndajë informacion dhe të edukojë njerëzit për rëndësinë e shëndetit të gjirit, për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit të gratë dhe vajzat në të gjithë botën. Albsig Jetë në kuadër të përgjegjësisë sociale i është bashkuar një sërë kauzash sociale ku një ndër to ishte dhe "Ndërgjegjësimi e Zbulimi i Hershëm i Kancerit të Gjirit".

Kauzë kjo ideuar e dizenuar për t'i ardhur në ndihmë çdo bashkëpunëtorëje. Albsig Jetë ka qenë dhe do të mbetet promotore e kauzave për jetën.

Rritje me 20% e rasteve me kancer gjiri, mjekja: Grupmosha 50-70 vjeç, më e prekura

Në Shqipëri kanceri i gjirit ka një tendencë në rritje. Numri i pacientëve të prekur me kancer gjiri në vendin tonë 10 vitet e fundit ka shënuar rritje me 20%. Gjatë viteve të fundit, rastet e prekura janë rritur me 20% ndërsa vdekshmëria shënon ulje të lehtë. Ai është kanceri më i shpeshtë tek gratë dhe i dyti në popullatën e përgjithshme në vend. Autoritetet thonë se kanë shtuar kapacitetet diagnostikuese dhe se në 6 spitale rajonale që prej vitit 2017 ofrohet dhe trajtimi me kimioterapi.

Vitet e mëparshme rastet e reja me kancer gjiri kanë qenë rreth 500, ndërsa tashmë shifra ka shkuar në mbi 700. Shefja e Shërbimit Onkologjik Silvana Çeliku në një prencim për televizionet kombëtarë tha se kjo sëmundje evidentohet më së shumti tek grupmoshat 50-70 vjeç, megjithatë edhe grupmoshat më të reja nuk mbeten pas. Apeli i specialistëve të shëndetit është që kontrollet të kryhen jo vetëm gjatë muajit Tetor, por përgjatë gjithë vitit, pasi diagnostikimi në kohë shpëton jetë. Sipas të dhënave 1 në 8 gra diagnostikohet me kancer të gjirit përgjatë jetës. Aktualisht kanceri i gjirit është sëmundja e dytë më e përhapur pas sëmundjeve kardiovaskulare.

192 vdekje në vit nga kanceri i gjirit në Shqipëri, gratë ende e kapin në faza të avancuara

Kanceri i gjirit është kanceri më i shpeshtë tek gratë edhe në Shqipëri. Mbi 720 raste janë diagnostikuar vitin e fundit me këtë sëmundje dhe sipas ekspertëve ky kancer përbën më shumë se 11% të të gjitha rasteve të reja me sëmundje tumorale. Dy dekadat e fundit sëmundshmëria nga kanceri i gjirit është rritur me 20%.

Shefja e shërbimit onkologjik Silvana Çeliku tregon se krahas faktorit genetik, ndryshimit të stilit të jetës dhe rritjes së moshës mesatare, programi i depistimit në të gjithë vendin ka rritur zbulueshmërinë e këtij kanceri. Pavarësisht fushatave të vazhdueshme për diagnostikimin e hershëm të kësaj sëmundje, fatkeqësisht ende gratë e kapin sëmundjen në stadi të avancuar.

Për këtë arsye kanceri i gjirit në Shqipëri mbetet shkaku kryesor i vdekjeve tek femrat e prekura nga sëmundjet tumorale. Vetëm në vitin 2022 humbën jetën 192 gra edhe në moshë të re. Në tetorin rozë, muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit mjekja Silvana Çeliku u bën apel grave të kryejnë kontrolle periodike. Thirrjet nuk mungojnë as për meshkujt të cilët konstatojnë anomali në gjoksin e tyre.

1% të rasteve më kancer të gjirit e zënë meshkujt. Aktualisht në spitalin Onkologjik trajtohen 4 pacientë meshkuj të prekur nga kjo sëmundje.





Pensionet Private, Fondi “Albsig Invest” sh.s., Alternativa e Duhur për Shqiptarët

Në përgjithësi, pjesa më e madhe e popullatës në Shqipëri e ka konsideruar fondin e pensionit si detyrim, barrë financiare ngarkuar nga shteti. Mungesa e kulturës financiare dhe në veçanti mungesa e njohurive të zgjeruara mbi sigurimet, si dhe historiku i deri tanishëm i tregjeve financiare në Shqipëri, janë disa nga elementet kryesorë që pengojnë zhvillimin në këtë fushë. Aktualisht, tregu i pensioneve private është një treg i ri, me një mision të rëndësishëm. Megjithatë, mjafton të vrojtosh ritmet me të cilat po zhvillohet ky treg, në raport me treguesit ekonomik dhe arrin të vlerësosh rritjen e interesit publik dhe domosdoshmërinë e fuqizimit të tij.

Në këtë kontekst, ka lindur nevoja për reformimin e sistemit të pensioneve, duke u fokusuar në gjetjen e rrugëve të përshtatshme dhe të drejta të financimit, dhe konkretisht ndarjen e përgjegjësi të përbashkëta të mbulimit të nevojave jetësore në pleqëri, midis shtetit dhe individit. Një nga sistemet që po funksionon sot me sukses është fondi i pensionit vullnetar privat.

Pensionet Private, Kalvari dhe Peripecitë e Formimit të një Kulture në Treg

Qytetarët kanë rritur interesin për të investuar në skemat e pensioneve private. Tregu i pensioneve private në Shqipëri është ende i ri dhe zgjerimi i mirëfilltë i fondeve të pensionit nisi vetëm një dekadë më parë, pas përfshirjes së investitorëve me përvojë nga tregu bankar dhe ai i sigurimeve shtetërore.

Megjithë përpjekjet e shtuara në drejtim të zhvillimit të këtij tregu gjatë viteve të fundit, pesha absolute e vlerës së këtij tregu mbetet e papërfillshme kundrejt madhësisë totale të sektorit financiar në vend.

Pensionet private janë një alternativë shtesë për të siguruar të ardhura të qëndrueshme pas moshës 65 vjeçare, të ardhura të cilat konsiderohet ndihmë shtesë për të ruajtur standardet e jetesës pas pensionit. Politikat e pensioneve private synojnë t'i sigurojnë pensionistëve të ardhura të rregullta në baza mujore, që ndikojnë në uljen e probabilitetit që ata të preken nga varfëria, por gjithashtu edhe duke mos i përjashtuar ata nga skema sociale. Këto fonde kryesisht po nixten dhe po përdoren gjerësisht nga skemat e pensioneve të ndërmarrjeve private, që ofrohen në formën e përfitimeve për punonjësit. Skemat funksionojnë nëpërmjet kontributeve të derdhura nga punëdhënësit, në favor të punëmarrësve ose nëpërmjet kontributit të përbashkët. Kjo praktikë specifike është aplikuar dhe nga Fondi i Pensionit Vullnetar "Albsig Invest" sh.a, pjesë e Kastrati Group.

Çfarë është Fondi i Pensionit Vullnetar "Albsig Invest"?

Fondi i Pensionit Vullnetar "Albsig Invest" është një alternativë për të patur të ardhura shtesë përveç pensionit të garantuar shtetëror. Fondi është ideuar dhe krijuar për të shmangur problematikat e sistemit shtetëror, ku si rrjedhojë e rritjes së jetëgjatësisë, nuk arrin të sigurojë të ardhura të mjaftueshme për një pjesë të konsiderueshme të popullësisë, në momentin që arrijnë moshën e pensionit. Politikat dhe procedurat rigorozë të Fondit të Pensionit "Albsig Invest" të miratuara edhe nga rregullatori shtetëror në fushën e sigurimeve, Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka mirëpërcaktuar se fondet e depozituara për pension suplementar pranë Albsig do të investohen vetëm në obligacione afatgjata të Republikës së Shqipërisë. Tradicionalisht obligacionet qeveritare janë aset me rrezikun më të ulët, ndër asetet e tjera në tregun e kapitaleve dhe konsiderohen me rrezik zero.

Si Mund të Anëtarësohesh në Fondin "Albsig Invest"?

Fondi i Pensioneve "Albsig Invest" me qëllim për t'i ardhur në ndihmë çdo konsumatori ka hartuar dy lloje skemash efikase dhe shumë qartësisht të kuptueshme për të gjithë grupin e synuar të interesit. Skemat janë ndarë në dy grupe, skema profesionale dhe skema individuale:

Skema Profesionale

Bizneset e mëdha, me një numër të konsiderueshëm punonjësish, janë ata që janë bërë iniciatorë në këtë skemë. Në skemën profesionale punëdhënësi dhe punëmarrësi (individi) kontribuojnë së bashku në llogarinë e hapur për punëmarrësin (individin). Një grup i madh biznesesh kanë përzgjedhur Fondin e Pensionit Vullnetar "Albsig Invest". Vlen të theksojmë se nga përvoja dy vjeçare e këtij Fondi duket qartë dhe përqindja në treg e bizneseve që kanë përzgjedhur këtë të fundit.

Skema Individuale

Skema individuale është ideuar dhe krijuar që individi (punëmarrësi) të kontribuojë bazuar në mundësitë financiare që mund të ketë çdo muaj. Në skemën individuale vetëm individi (punëmarrësi) kontribuon në masën e dëshiruar.

Shtirja në Kohë, Politika më e Mirë e Investimit

Element i rëndësishëm që shoqëron investimin për pension është kohëzgjatja. Sa më gjatë ta kesh kohën e investimit, aq me frytdhënës do të jetë dhe investimi që bën. Fondi do të investojë kryesisht në obligacione afatgjata të Shtetit Shqiptar. Objektivi i Fondit të Pensioneve Vullnetare "Albsig" është optimizimi i normës së kthimit, duke ruajtur principalin dhe duke monitoruar tolerancat për një rrezik sa më të ulët. Njëkohësisht është shumë e rëndësishme horizonti i investimit. Horizonti i investimit duhet të jetë afatgjatë, konkretisht duke nisur nga 10 deri në 30 vjet.

Çfarë Përfiton një Anëtar i Fondit të Pensioneve Vullnetare "Albsig Invest", në Momentin kur Bëhet Pjesë e Tij?

Çdo anëtar i Fondit të Pensionit Vullnetar "Albsig Invest" ka të drejtë të përfitojë shumën e investuar, e akumuluar në format e paraqitura më poshtë, kur përmbush kushtet përkatëse të specifikua sipas kategorive ku ata bëjnë pjesë si:

• **Pension Pleqërie:** kur mbush moshën e pensionit të parashikuar në ligjin për sigurimet shoqërore;

• **Pension të Parakohshëm:** 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit të parashikuar në ligjin për sigurimet shoqërore;

• **Pension Invaliditeti:** kur bëhet i paafte për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

• **Pension Familjar:** në rastin kur anëtar i vdes përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij/saj u shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

Pse të Anëtarësohemi në Fondi i Pensioneve "Albsig Invest"?

Ndryshe nga sistemi tradicional i pensioneve në shtet, sistemi privat i pensioneve ka një sërë avantazhesh për të gjithë konsumatorët që mendojnë të bëhen pjesë e tij për një jetë më të mirë. Investimi në këtë fushë ka bërë që një pjesë e mirë e konsumatorëve të përfitojnë nga kontributet e derdhura çdo vit. Për efekt llogaritje tatimi, kontributet periodike janë të zbritshme nga paga bruto. Investimet në fond janë të përjashtuara nga tatimi mbi interesin dhe të ardhurat nga kapitali. Gjithashtu, dhe në rast të humbjes së jetës, fondi i pensionit është i trashëgueshëm. Investimet kryhen nga profesionistë shumë të specializuar për të kryer investimet më të duhura për fondin e pensionit, e cila ndikon pozitivisht mbi normën e kthimit. Për më tepër, theksojmë se avantazhi kryesor i fondeve të pensionit në krahasim me investimet individuale, është mundësia e diversifikimit që ofrojnë fondet.

Metoda e Aplikimit, Transparencë e Plotë

Në kuadër të transparencës dhe mundësisë për të kontrolluar dhe verifikuar llogarinë personale online, çdo anëtar që bëhet pjesë e

Fondit Vullnetar "Albsig Invest" (nëse e përdor këtu Albsig Invest duhet sqaruar që lart terminologjia) pajiset me një emër përdoruesi (username) dhe fjalëkalim (password).

Në llogarinë e tyre personale paraqiten të gjitha kontributet e kryera, norma e kthimit të Fondit dhe informacione të tjera të rëndësishme. Fondi i Pensionit Vullnetar "Albsig" është i trashëgueshëm për familjen dhe lejohet depozitimi dhe i shumave të vogla të parave.

Sa Duhet të Paguaj? Pyetja që Bëhet më Shpesh

Pyetja me të cilën hasemi më shpesh nga shumica e të interesuarve është shuma që duhet të paguajnë në Fond. Për ta bërë sa më të aksesueshme nga të gjithë pjesëmarrjen në Fonde të tilla Sigurimi, ekspertët e fushës kanë hartuar politika të tilla, që investimet e bëra të jenë në bazë të çdo mundësie financiare që gjithësecili prej nesh ka. Për t'i krijuar gjithkujt mundësinë e pjesëmarrjes në fonde pensioni vullnetar, shuma minimale e kontributit është menduar të fillojë nga 1,000 lekë në muaj. Dëshirojmë të theksojmë fort se është shumë e rëndësishme hyrja në fond, sa më herët për çdo kontribues pasi aq më shumë fitimprurës do të jetë investimi dhe si rrjedhojë edhe të ardhurat shtesë të përfituara në moshën pas daljes në pension.

Po në Rast Paaftësie apo Humbje Jete, Çfarë Ndodh me Kontributet?

Në rast sëmundjeje apo aksidenti gjatë kohës së anëtarësimit, ju përfiton pension invaliditeti, të cilin e merrni pranë Fondit të Pensioneve "Albsig" deri në përfundim të aseteve në llogarinë tuaj.

Në rast humbjeje jete të personit që ka investuar, e gjithë shuma e mbetur e kontributeve, së bashku me interesat i kalon familjarëve të tij (trashëgimtarët përfitojnë pension familjar).

Ku Mund të Anëtarësoheni?

Mos prit më gjatë! Mendo për një pleqëri të mbarë dhe pa probleme ekonomike. Nis investimin tënd edhe për vitet e pensionit! Për të gjithë të interesuarit, për t'u anëtarësuar në Fondin Vullnetar "Albsig", përveç mundësive të aplikimit online, ata mund të drejtohen pranë rrjetit të degëve të "Albsig" sh.a., në të gjithë Shqipërinë ose pranë zyrave qendrore të "Albsig Invest" në Tiranë.

Anëtarët e Fondit Vullnetar Albsig Shpërblehen me Karta Klienti Anëtarët e Fondit "Albsig Invest" shpërblehen me karta klienti për mundësi uljesh në të gjithë gamën e produkteve dhe të shërbimeve në "Albsig" sh.a. Për shërbimet spitalore e shënde tësore të gjithë anëtarët e Fondit të Pensioneve "Albsig Invest", pajisen me kartën e anëtarësimit "Albsig MED", me anë të së cilës përfitojnë ulje në të gjithë rrjetin privat spitalor. Përfitimet e klientëve nuk mbesin këtu, pasi "Albsig Invest" ka menduar më shumë për klientët. Për të gjithë anëtarët e Fondit Vullnetar të Pensionit "Albsig", që janë klientë besnikë të "Albsig", pajisen me kartën e përgjithshme të klientit, përmes së cilës ata përfitojnë ulje për produktet, si më poshtë:

- Deri në 25% bonus për sigurimet vullnetare të makinës;
- Deri në 20% bonus për sigurimin vullnetar të shtëpisë;
- Deri në 50% bonus për sigurimin e shëndetit në udhëtim.



Fondi i Pensionit
Albsig

albsiginvest.al 



Kontribuo për të
ardhmen tënde që sot

nga

1000 lekë në muaj



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL